



## MUAJI QERSHOR

- 1. † E martë.** Kujtimi i Shenjtërimit të Katedrales së Ngjalljes, në Tiranë. Dëshmor Justin Filozofi.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

### **Liturgjia Hyjnore**

APOSTULLI i së martës së javës së 5-të të Veprave (Vep. 12:25-13:12).

UNGJILLI i së martës së javës së 5-të të Joanit (Jn. 8:51-59).

- 2. E mërkurë.** *Mbyllja e së kremtes së Gjysmëpendikostisë.* Omologjet Niqifori i Konstandinopojës. Hierodëshmor Erazmi etj. në Ohër. Dëshmor Leandri.

Shërbesa psalet si në librin e Pesëdhjetores, si ditën e së kremtes, por në Mbrëmësore nuk thuhet leximet biblike. Në Mëngjesore nuk lexohet Sinaksari i Pesëdhjetores, por vetëm i ditës.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 5-të të Veprave (Vep. 13:13-24).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 5-të të Joanit (Jn. 6:5-14).

- 3. E enjte.** Dëshmor Lukiliani, Pavla dhe 4 fëmijët. Mbretëresha Klotilda. Oshënar Kevini. Dëshmor Komini.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 5-të të Veprave (Vep. 14:20-15:14).

UNJILLI i së enjtes së javës së 5-të të Joanit (Jn. 9:39-10:9).

- 4. E premte.** Marta dhe Maria, motrat e Llazarit të katërditshëm. Mitrofani i Konstandinopojës. *Në Elbasan, në Manastirin e Shën Joan Vladimirit, kremtohet Joan Vladimiri.*

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i hierarkut (Heb. 7:26-8:2).

UNJILLI i hierarkut (Jn. 10:1-9).

- 5. † E shtunë.** *Mbyllja e së kremtes së Samaritanes.* Hierodëshmor Dhorotheu i Tërës. Igori, mbret i Kievit. Plutarku i Qipros. Dëshmorët Nikandri, Gorgji dhe Apolloni.

Shërbesa psalet sipas rendit në librin e Pesëdhjetores. Thuhet vetëm Shkurtorja dhe Dërgimsorja e së kremtes së Samaritanes.

APOSTULLI i së shtunës së javës së 5-të të Veprave (Vep. 15:35-41).

UNJILLI i së shtunës së javës së 5-të të Joanit (Jn. 10:27-38).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “Ngazëlleni, o të drejtë...”.

Në vend të “Pamë dritën...”, psalet “Krishti u ngjall...”.

## 6. † E DIEL. VI PAS PASHKËS (Shërimi i të verbrit).

Oshënar Ilarioni i Ri. Oshënarët Atali dhe Anuvi, mrekullibërës.

**Tingulli Tërthor I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VIII.**

**Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”. “Krishti u ngjall...” (3 herë: 1 herë nga prifti dhe 2 herë nga kori), PSALMI NISTOR (Ps. 103), pa vargjet: “Ejani t’i falemi...” (të cilat nuk thuhën deri në mbylljen e Pashkës) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 7 Vargëzimet ngjallësore dhe 2 Vargëzimet e Pesëdhjetores, që bëhen 3 (në Pesëdhjetoren e Vogël). “Lavdi...”, e Pesëdhjetores: “O Zot, duke shkuar në udhë...”. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. I: “Në Detin e Kuq...”.

PASVARGJET: pasvargu i parë ngjallësor dhe Vargëzimet e Pashkës: “Pashka hierore...” etj., bashkë me vargjet e tyre: “Le të ngjallet Perëndia...” etj. “Lavdi...”, e Pesëdhjetores: “Krishti Perëndi, dielli mendor i drejtësisë...”. “Tani...”, e Pashkës: “Ditë e Ngjalljes...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

**Në Mëngjesore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”. “Krishti u ngjall...” (3 herë: 1 herë nga prifti dhe 2 herë nga kori) dhe shërbesa vazhdon si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTE ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fjalën e panisëshme...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gëzohu, derë e Zotit...”.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës. BEKIMTORET ngjallësore, SHKALLESAT, DËGJIMI dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e Pesëdhjetores. SINAKSARI i ditës dhe i Pesëdhjetores.

ZBRITËSORET: “Shpëtimtar Perëndi...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor VIII.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui prej varrit...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të “Më të nderuarën...”, psalen Madhështimet e Pashkës: “O shpirt, madhështoje... Ndriçohu, ndriçohu...” dhe Zbritësorja IX: “Ty, o Nën’ e Perëndisë...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORET: e Pashkës dhe e Pesëdhjetores.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzimet ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e Pashkës: “Pashka hierore...” etj., bashkë

me vargjet e tyre: “Le të ngjallet Perëndia...” etj. “Lavdi...”, e Pesëdhjetores: “Cili do të flasë...”. “Tani...”, e Pashkës: “Ditë e Ngjalljes... Krishti u ngjall...” (1 herë).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET dhe Hyrtorja e Pashkës.

Pas HYRJES: nuk psalet sërish “Krishti u ngjall...”, por psalet menjëherë Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja ngjallësore: “Megjithëse zbritë në varr...”.

APOSTULLI i së dielës së 6-të të Veprave (Vep. 16:16-34).

UNGJILLI i së dielës së 6-të të Joanit (Jn. 9:1-38).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i Pashkës: “Një engjëll i thërriste... Ndriçohu, ndriçohu...”.

KUNGATORJA: “Trupin e Krishtit kungoni...”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet: “Krishti u ngjall...”.

## **7. E hënë.** Hierodëshmor Theodhoti. Dëshmoret Zinaida, Esia, Valeria, Suzana. Oshënar Anatoli.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 6-të të Veprave (Vep. 17:1-9).

UNGJILLI i së hënës së javës së 6-të të Joanit (Jn. 11:47-54).

**8. E martë.** *Mbyllja e të kremtes së shërimit të të verbrit.*  
Transferimi i lipsanit të shën Theodhor Stratilatit.  
Dëshmore Kaliopi. Dëshmor Nikandri.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 6-të të Veprave  
(Vep. 17:19-28).

UNGJILLI i së martës së javës së 6-të të Joanit  
(Jn. 12:19-36).

**9. † E mërkurë.** *Mbyllja e së kremtes së Pashkës.* Kirili i  
Aleksandrisë. Dëshmoret Mariamna, Marta, Maria,  
Enatha.

**Në Mbrëmësore:**

Në vend të thirrjes: “I bekuar...”, prifti, duke  
temjanisur para Tryezës së shenjtë, thotë thirrjen: “Lavdi  
Trinisë së shenjtë, të njëqenëshme...”, dhe më pas psalet:  
“Krishti u ngjall...” (10 herë), bashkë me vargjet, njëlloj  
si të Dielën e Pashkës. Në vazhdim kryhet shërbesa e  
Mbrëmësore së Pashkës, si të Dielën e Pashkës, por,  
pas Hyrjes, thuhet paravargu i ditës. Përlëshimi kryhet  
njëlloj siç kryhet Javën e Ndrithshme.

**Në Mëngjesore:**

Në vend të thirrjes: “I bekuar...”, prifti, duke  
temjanisur para Tryezës së shenjtë, thotë thirrjen: “Lavdi  
Trinisë së shenjtë, të njëqenëshme...”, dhe më pas psalet:  
“Krishti u ngjall...” (10 herë), bashkë me vargjet, njëlloj  
si të Dielën e Pashkës. Në vazhdim thuhet Paqësoret  
dhe psalet kanoni i Pashkës. Në fund të çdo kënge,

thuhet Zbritësorja e Pashkës, “Krishti u ngjall...” (3 herë), “Kur u ngrit Jisui prej varrit...” (1 herë) dhe Litanja e Vogël: “Përsëri dhe përsëri...”, njëlloj si të dielën e Pashkës. Pas Shkurtores dhe Shtëpisë së Pashkës, thuhet vetëm Sinaksari i ditës. Menjëherë pas Sinaksarit, lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” (3 herë) dhe “Kur u ngrit Jisui prej varrit...” (3 herë), dhe vazhdon pjesa tjetër e Mëngjesores njëlloj si të dielën e Pashkës.

**Liturgia Hyjnore:**

ANDIFONET dhe HYRTORJA e Pashkës.

Pas HYRJES: “Krishti u ngjall...”, dëgjimi i Pashkës: “Kur erdhën gratë...” dhe Shkurtorja ngjallësore: “Megjithëse zbritë në varr...”.

Në vend të Himnit trishenjtor, psalet: “SA U PAGËZUAT më Krishtin...”.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 6-të të Veprave (Vep. 18:22-28).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 6-të të Joanit (Jn. 12:36-47).

Pjesa e mbetur e Liturgjisë njëlloj si të dielën e Pashkës.

**10. † E ENJTE. NGJITJA E ZOTIT, PERËNDISË DHE SHPËTIMTARIT TONË JISU KRISHT NË QIEJ (ANALIPSI- SHESTJA).** Dëshmorët Aleksandri dhe Andonina. Dëshmore Oliva.

**Në Mbrëmësore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzimet e së kremtes (duke përsëritur të parën 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Isa. 2:2-3; **Leximi II:** Isa. 62:10-63:3, 7-9; **Leximi III:** Zah. 14:4, 8-11).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që u ngjit me lavdi në qiej dhe ndenji në të djathtë të Perëndisë dhe Atit, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

**Shënime:** *Nga sot deri të Dielën e Pendikostisë, shërbesat e shenjta (Pasdarka, Mesnata, Mëngjesorja dhe Orët), fillojnë në këtë mënyrë: Pas thirrjes: “I bekuar...”, thuhet menjëherë: “Shenjt Perëndi...”, “Trini e Tërëshenjtë...”, “Ati ynë...”. Dhe pjesa tjetër e shërbesës. Pra, nuk thuhet “O Mbret qiellor...”.*

### **Mëngjesorja:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (thuhet Ungjilli mëngjesor III, por lexohet te Dera e Bukur).

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”,



tropari i vetëmelodishëm i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës dhe i Pesëdhjetores.

ZBRITËSORET e së kremtes: “Mjegull e mbuloi belbacakun ...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet: “Hyjli-ndësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve (vargu i Kanonit të parë: “Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty”; vargu i Kanonit të dytë: “Engjëjt duke parë ngjitjen e Zotit, çuditëshin si u ngjit me lavdi prej tokës në më të lartat”) dhe në fund thuhet Zbritësorja IX.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e së kremtes, që bëhen 4. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: “*U ngjit Perëndia me brohori, Zoti me bujë trumbetash. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u ngjite në qiej me lavdi, ne që të psalim: Aliluia*”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes. “Shenjt Perëndi...”.

APOSTULLI i së kremtes (Vep. 1:1-12).

UNGJILLI i së kremtes (Lk. 24:36-53).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të kanonit të së kremtes.

KUNGATORJA: “U ngjit Perëndia me brohori, Zoti me bujë trumbetash. Aliluia”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes.

“EMRI I ZOTIT...” dhe Përlëshimi si në Mbrëmësore.

### **Shënime:**

**1.** Nga Mbrëmësorja që u krye dje e në vazhdim, përpara psalmit nistor (Ps. 103) shtohen vargu: “Ejani t’i falemi...” (3 herë).

**2.** Deri ditën e mbylljes të së kremtes, nëse rastis ndonjë shenjtor i madh kremtues, si Zbritësore psalen irmoset: “Mjegull’ e mbuloi belbacakun...”.

**3.** Në Liturgjitë Hyjnore të përditshme, deri ditën e mbylljes të së kremtes së Ngjitjes së Zotit në Qiej, psalen Andifonet e së kremtes, por psalet Hyrtorja: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u ngjite në qiej me lavdi...”; shkurtorja e të kremtes; te “Veçan të Tërëshenjtnë...” psalet “Të meriton...”; në vend të “Pamë dritën...” psalet Përlëshorja e së kremtes; “Emri i Zotit...” dhe Përlëshimi i së kremtes.

**4.** Nga sot deri ditën e mbylljes të së kremtes, te “Tani...” e Përlëshoreve psalet Përlëshorja e së kremtes.

**11. E premte.** Apostujt Vartholomeu dhe Varnava. Dëshmorët në Kinë. Lukai i Krimesë, mjeku.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i shenjtorëve (kërkoje të dielën e javës së 5-të të Veprave - Vep. 11:19-30).

UNJILLI i shenjtorëve (8 nëntor – Llk. 10:16-21).

**12. † E shtunë.** Oshënar Onufër Egjiptiani. Oshënar Petro Athoniti. Oshënarët dëshmorë të rinj Sinesi, Pavli.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

**Në Liturgjinë Hyjnore:**

APOSTULLI i së shtunës së javës së 6-të të Veprave (Vep. 20:7-12).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 6-të të Joanit (Jn. 14:10-21).

**13. † E DIEL. VII PAS PASHKËS.** (318 Etërit e Sinodit I Ekumenik). Dëshmore Akilina në Liban. Evlogji i Antiokisë.

**Tingulli Tërthor II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor X.**

**Në Mbrëmësore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzime ngjallësore, 3 Vargëzime të Ngjitjes në Qiej dhe 4 të Etërve. “Lavdi...”, e Etërve (në Pesëdhjetoren e Vogël). “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. II: “Cili nuk do të të lumërojë...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Gjen. 14:14-20; **Leximi II:** Ligj. Për. 1:8-11, 15-17; **Leximi III:** Ligj. Për. 10:14-21).

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Etërve. “Tani...”, e Ngjitjes në Qiej (në Pesëdhjetoren e Vogël).

PËRLËSHORJA ngjallësore. “Lavdi...”, e Etërve. “Tani...”, e Ngjitjes në Qiej.

**PËRLËSHIMI:** “Ai që u ngjall së vdekurish dhe u ngjit me lavdi në qiej dhe ndenji në të djathtë të Perëndisë dhe Atit, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

### **Në Mëngjesore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “**PERËNDI ËSHTË ZOTI...**”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

**NDENJËSORET** ngjallësore. **BEKIMTORET** ngjallësore. **DËGJIMI**, **SHKALLESAT** dhe **PARAVARGU** i tingullit.

**SHKURTORJA** dhe **SHTËPIA** e Etërve. **SINAKSARI** i ditës dhe i Pesëdhjetores.

**ZBRITËSORET** e së kremtes: “Mjegull’ e mbuloj belbacakun ...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor X.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmit 50 psalet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

**MADHËSHTIMET:** pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund **Zbritësorja IX**.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

**DËRGIMSORJA** ngjallësore, e Etërve dhe e Ngjitjes në Qiej.

**LAVDËRIMET:** psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzime të Etërve. “Lavdi...”, e Etërve (në Pesëdhjetoren e Vogël). “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

**Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes së Ngjitjes në Qiej, por tek andifoni i dytë thuhet ky refren: “Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish...*”, ndërsa tek andifoni i tretë, si refren thuhet Përlëshorja e së kremtes së Ngjitjes në Qiej.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjite në qiej me laudi*, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore e Ngjitjes në Qiej, e Etërve dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes së Ngjitjes në Qiej.

APOSTULLI i së dielës së 7-të të Veprave (Vep. 20:16-18, 28-36).

UNGJILLI i së dielës së 7-të të Pashkës (Jn. 17:1-13). Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes së Ngjitjes.

**14. † E hënë.** Profeti Elisé. Oshënar Nifon Athoniti nga Lukova. Omologjet Metodi i Konstandinopojës.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

**Liturgjia Hyjnore**

APOSTULLI i së hënës së javës së 7-të të Veprave (Vep. 21:8-14).

UNGJILLI i profetit (kërkoje të premtën e javës së 1-rë të Llukait- Llk. 4:22-30).

**15. E martë.** Profeti Amos. Apostujt Stefanai dhe Akaiku nga të 70-t. Oshënar Jeronimi. Agustini i Iponës.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 7-të të Veprave (Vep. 21:26-32).

UNGJILLI i së martës së javës së 7-të të Joanit (Jn. 16:2-12).

**16. E mërkurë.** Tihoni i Amathundës. Dëshmoret Neonila dhe Gresina. Aureliani i Arles.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 7-të të Veprave (Vep. 23:1-11).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 7-të të Joanit (Jn. 16:15-23).

**17. † E enjte.** Dëshmor Isavri, Ermia, Feliksi, Peregrini, Vasili, Inocenti martirizuar në Apolloni (Fier). Dëshmorët Ismaili, Saveli dhe Emanueli.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

**Liturgjia Hyjnore**

APOSTULLI i së enjtes së javës së 7-të të Veprave (Vep. 25:13-19).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 7-të të Joanit (Jn. 16:22-33).

**18. E premtë.** *Mbyllja e së kremtes së Ngjitjes së Zotit në Qiej.* Dëshmorët Leonti, Ipati, Theodhuli, Eteri. Amandi i Bordosë.

Shërbesa psalet si në librin e Pesëdhjetores, njëlloj si ditën kryesore të së kremtes, por në Mbrëmësore nuk thuhet leximet biblike të së kremtes dhe nuk psalen troparet e Litisë. Në Mëngjesore, nuk thuhet Polielei, Ndenjësorja e polieleit dhe Ungjilli mëngjesor, bashkë me ato që thuhet para dhe pas Ungjillit. Prandaj, pas dy Ndenjësoreve lexohet menjëherë Psalmi 50 dhe psalen Zbritësoret. Thuhet vetëm Sinaksari i ditës.

APOSTULLI i së premtës së javës së 7-të të Veprave (Vep. 27:1-28:1)

UNGJILLI i së premtës së javës së 7-të të Joanit (Jn. 17:18-26).

**19. † E shtunë. Para Pendikostisë (E Shpirtrave** -Kujtimi i të gjithë të krishterëve shpresëtarë që kanë ndërruar jetë ndër shekuj.). Apostull Juda i Tadeut. Apostull Juda, fis i Krishtit. Oshënar Paisi i Madh. Joani i Shangait.

Shërbesat psalen sipas rendit të librit të Pesëdhjetores.

**20. † E DIEL. PENDIKOSTIA (Pesëdhjetorja-Rrëshajat).** Hierodëshmor Metodi i Patarës. Nikolla Kavasila. Kalisti i Konstandinopojës.

**Në Mbrëmësore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 8 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 10 (e para dhe e katërta thuhën nga 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Num. 11:16-17, 24-29; **Leximi II:** Joel. 2:23-3:5; **Leximi III:** Ezek. 36:24-28).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që dërgoi prej qiellit në formë gjuhësh të zjarrta Shpirtin e Tërëshenjtë mbi nxënësit dhe apostujt e tij të shenjtë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

### **Në Mëngjesore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (thuhet Ungjilli mëngjesor ngjallësor IX, por lexohet te Dera e Bukur – Jn. 20:19-23).

Nuk lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...”, por menjëherë pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 psalet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes.



Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.  
 SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes.  
 SINAKSARI i ditës dhe i Pesëdhjetores.

ZBRITËSORET dyshe të së kremtes: “Mjegull e mbuloi belbacakun...” dhe “Zoti e mbyti krejt...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e kanoneve dhe në fund thuhet Zbritësorja IX.

DËRGIMSORET e së kremtes (e para thuhet 2 herë, ndërsa e dyta thuhet 1 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e së kremtes, që bëhen 4. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes. Tek Andifoni II, thuhet ky refren: “Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të...”, ndërsa tek Andifoni III, si refren thuhet Përlëshorja e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: “*Lartësohu me fuqinë tënde, o Zot. Do t'i këndojmë dhe t'i lavdërojmë mrekullitë e tua. Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të psalim: Aliluia*”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

Në vend të “Shenjt Perëndi...”, psalet: “Sa u pagëzuar më Krishtin...”.

APOSTULLI i së kremtes (Vep. 2:1-11).

UNJILLI i së kremtes (Jn. 7:37-52, 8:12).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të Kanonit të së kremtes.

KUNGATORJA: “Fryma jote e mirë do të më udhëheqë në vend të drejtë. Aliluia”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes.

“EMRI I ZOTIT...” dhe Përlëshimi si në Mbrëmësore.

Menjëherë pas Përlëshimit, zakonisht, kryhet shërbesa e **Mbrëmësores**, si më poshtë.

### **Mbrëmësorja e Gjunjzimit:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”. “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET e veçanta për Mbrëmësoren e Gjunjzimit (shih Pesëdhjetoren e Vogël).

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “O Mbret qiellor...” (te Vargëzimet e Lavdërimeve të Mëngjesores së Pendikostisë, në Pesëdhjetoren e Vogël).

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i madh: “Cila Perëndi...”.

Në vazhdim thuhet uratat e gjunjzimit sipas rendit të Pesëdhjetores (në Pesëdhjetoren e Vogël).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI si në librin e Pesëdhjetores (në Pesëdhjetoren e Vogël).

**21. † E HËNË. E SHPIRTIT TË SHENJTË.** Hierodëshmor Terenti i Ikonisë. Dëshmor Juliani.

**Në Mëngjesore:**

Pas thirrjes së priftit: “I bekuar...”, thuhet tropari: “O Mbret qiellor...”, Trishenjti dhe vazhdimi i Mëngjesores. Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes (vetëm dy Ndenjësoret e para, në Mëngjesoren e Pendikostisë).

Menjëherë pas Ndenjësoreve lexohet PSALMI 50.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës dhe i Pesëdhjetores.

ZBRITËSORET jambike të së kremtes: “Mjegull e mbuloi belbacakun...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e kanoneve dhe në fund thuhet Zbritësorja IX.

DËRGIMSORET e së kremtes (e para thuhet 2 herë, ndërsa e dyta thuhet 1 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e së kremtes, që bëhen 4. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (në Pesëdhjetoren e Vogël).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

**Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes. Tek Andifoni II, thuhet ky refren: “Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të...”, ndërsa tek Andifoni III, si refren thuhet Përlëshorja e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: “*Lartësohu me fuqinë tënde, o Zot. Do t’i këndojmë dhe t’i lavdërojmë mrekullitë e tua. Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të psalim: Aliluia*”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

Në vend të “Shenjt Perëndi...”, psalet “Sa u pagëzuar më Krishtin...”.

APOSTULLI i së hënës së Shpirtit të Shenjtë (Efes. 5:8-19).

UNJILLI i së hënës së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 18:10-20).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të kanonit të së kremtes.

KUNGATORJA: “Mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë, o Njeridashës. Aliluia”.

Psalet: “PAMË DRITËN...”, “Emri i Zotit...” dhe Përlëshimi si të shtunën në Mbrëmësore.

### **Shënime:**

1. *Këtë javë hahen të gjitha.*
2. *Deri ditën e mbylles të së kremtes së Pendikostisë, në Liturgji thuhet Andifonet dhe Hyrtorja e së kremtes.*
3. *Nga sot fillon leximi i Letrave të Apostull Pavlit dhe leximi i Ungjillit të shenjtë sipas Mattheut.*

**22. E martë.** Hierodëshmor Eusebi i Samosatës. Dëshmor Zinoni, Zinai. Dëshmor Albani në Britani.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 1-rë të Letrave (Rom. 1:1-7, 13-17).

UNGJILLI i së martës së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 4:23-5:13).

**23. E mërkurë.** Dëshmore Agripina. Dëshmorët Evstohu, Lolia etj. Dëshmorët Aristokliu, Dhimitriani, Athanasi.

Hahen të gjitha

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 1-rë të Letrave (Rom. 1:18-27).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 5:20-26).

**24. † E enjte.** Lindja e Pararendësit dhe Pagëzorit Joan. Mbledhja adhuruese në nderim të prindërve të tij, Zaharisë dhe Elisabetës.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

**Liturgjia Hyjnore**

APOSTULLI i Pararendësit (Rom. 13:11-14:4).

UNGJILLI i Pararendësit (Lk. 1:1-25, 57-68, 76, 80).

**25. E premte.** Oshënare dëshmore Fevronia, Livia etj. Dëshmor Orenti dhe ata që ishin me të. Oshënar Dionisi në Athos.

Hahen të gjitha

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 1-rë të Letrave (Rom. 2:14-28).

UNGJILLI i së premtes së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 5:33-41).

**26. † SHTUNË.** *Mbyllja e Pendikostisë.* Oshënar Davidi në Selanik. Joani i Gotisë. Hierodëshmor Vigjili i Trentos.

Shërbesa kryhet njëlloj si të Dielën e Pendikostisë, por:

**Në Mbrëmësore,** Vargëzimet e Thirrtoreve thuhën 8, jo 10, domethënë thuhën të gjitha nga 1 herë; leximet biblike dhe troparet e Litisë nuk thuhën.

**Në Mëngjesore,** nuk thuhet Polielei dhe Ndenjësorja e tij, nuk thuhet Ungjilli mëngjesor i së kremtes dhe as rendi para apo pas Ungjillit; nuk thuhet Sinaksari i Pesëdhjetores.

**Në Liturgji,** Andifonet, Hyrtoerja, Përlëshorja dhe Shkurtoerja thuhën si ditën e Pendikostisë. Thuhet Trishenjti.

APOSTULLI i së shtunës së javës së 1-rë të Letrave (Rom. 1:7-13).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 5:42-48).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të kanonit të së kremtes.

KUNGATORJA: “Fryma jote e mirë do të më udhëheqë në vend të drejtë. Alilua”.

Psalet “PAMË DRITËN...”.

**27. † E DIEL. I MATTHEUT. (E GJITHË SHENJTORËVE).** Joana Miroprurëse. Oshënar Samson Mikpritësi. Dëshmor Marki dhe Markia.

**Tingulli Tërthor IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor I.**

**Në Mbrëmësore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 vargëzimet ngjallësore dhe 4 vargëzimet e Pesëdhjetores. “Lavdi...”, e Pesëdhjetores. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. IV: “Mbreti i qiejve...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës: “Zoti mbretëroi...” dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** Isa. 43:9-14; **Leximi II:** Urt. Sol. 3:1-9; **Leximi III:** Urt. Sol. 5:15-6:3).

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Pesëdhjetores. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve ngjallësore të Ting. Tërth. II: “Zoti Krisht, Krijuesi dhe Çliruesi im...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Që lartazi zbritë...”. “Lavdi...”, e Pesëdhjetores. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

**Në Mëngjesore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore, sipas radhës, por te stikologjia (grupi) e parë psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Ti që linde për ne prej Virgjëreshës...”.

BEKIMTORET ngjallësore, SHKALLESAT, DËGJIMI DHE PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Pesëdhjetores) dhe SHTËPIA (e tingullit dhe e Pesëdhjetores). SINAKSARI i ditës dhe i Pesëdhjetores.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor I.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui prej varrit...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore dhe e Pesëdhjetores.

LAVDËRIMET: psalen 5 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të Pesëdhjetores. “Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore I. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Që lartazi...”, e Pesëdhjetores dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e Pesëdhjetores: “Si frytet e para...”.

APOSTULLI i së kremtes së Gjithë Shenjtorëve (Heb.11:33-12:2).

UNGJILLI i së dielës së javës së 1-rë të Mattheut (Mtth. 10:32-33, 37-38, 19:27-30).



Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “Ngazëlleni në Zotin, o të drejtë...”.  
“PAMË DRITËN...”.

**Shënime:**

1. *Deri në datën 26 korrik psalen Zbritësoret: “Ja gojën e çel tani...”, ndërsa në Liturgji Shkurtorja: “Mbrojtje e paturpëruar...”.*

2. *Nesër fillon kreshma e Apostujve të shenjtë, e cila zgjat vetëm 1 ditë.*

**28. E hënë.** Transferimi i lipsaneve të Anargjendëve Kir dhe Joan. Oshënarët Sergji dhe Gjermani në Valamo.

**Kreshma e Apostujve (këtë vit zgjat vetëm 1 ditë).**

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 2-të të Letrave (Rom. 2:28-3:18).

UNJILLI i së hënës së javës së 2-të të Mattheut (Mtth. 6:31-34, 7:9-11).

**29. † E martë.** Apostujt e shenjtë, të lavdëruar dhe të dëgjuar, protokorifenjtë Petro dhe Pavli.

**Në Mbrëmësore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzime të apostujve, të cilat bëhen 6 (përsëriten të tria nga 2 herë). “Lavdi...”, e apostujve. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike në të njëjtin tingull me Lavdinë e apostujve.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** 1 Pet. 1:3-9; **Leximi II:** 1 Pet. 1:13-19; **Leximi III:** 1 Pet. 2:11-24).

PASVARGJET e apostujve. “Lavdi...”, e apostujve. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve në të njëjtin tingull me Lavdinë e Pasvargjeve të apostujve.

PËRLËSHORJA e apostujve: “O parafronësit e apostujve...” (Ting. IV). “Lavdi...” dhe, “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

### **Në Mëngjesore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e apostujve: “O parafronësit e apostujve...” (Ting. IV). “Lavdi...”, po ajo: “O parafronësit e apostujve...” (Ting. IV). “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

NDENJËSORET e apostujve. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i apostujve.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i apostujve (Ungjilli mëngjesor ngjallësor XI).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmi 50: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i apostujve. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e apostujve. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORJA e apostujve dhe Hyjlindësorja e saj.  
 LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzimet e apostujve.  
 “Lavdi...”, e apostujve. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë apostujve.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e apostujve.

**Në Liturgji:**

ANDIFONET e të kremteve të apostujve.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e apostujve dhe e shenjtit të kishës.

Shkurtorja: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

APOSTULLI: i Apostull Pavlit (29 qershor – 2 Kor. 11:21-12:9).

UNJILLI: i Apostull Petros (29 qershor - Mtth. 16:13-19).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e apostujve.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

**30. † E mërkurë.** Mbledhja adhuruese në nderim të 12 Apostujve. Apostull Figeli i Efesit, nga të 70-t.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

**Liturgjia Hyjnore**

APOSTULLI i 12 Apostujve (1 Kor. 4:9-16).

UNJILLI i 12 Apostujve (Mtth. 9:36, 10:1-8).